# Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi

Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSB), mekanizma komunalë për siguri, janë krijuar për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në bashkësi. KKSB mëtojnë që të kenë anëtarë të ndryshëm, baraspeshë gjinore, nga shtresa të ndryshme nga të gjitha bashkësitë etnike dhe fetare në komunë, të cilët kanë rol në mirëqenien afatshkurtre dhe afatgjate të një bashkësie. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, KKSB duhet të takohen, së paku, gjashtë herë në vit. Përveç kësaj, komunave u kërkohet që të kompensojnë financiarisht anëtarët e KKSB-ve. Deri më tani, KKSB janë themeluar në 34 komuna.

KKSB kanë një qasje gjithëpërfshirëse për të përcaktuar se çka përfshihet me sigurinë në bashkësi dhe se kush është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt. Siguria dhe rendi në bashkësi janë përgjegjësi jo vetëm e Policisë së Kosovës, por edhe e zyrtarëve qeveritarë dhe shoqërisë civile. KKSB janë një forum i veçantë për t'i bërë bashkë këta hisedarë.

## Mandati 2018–2021










* Sipas nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të MPB dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012 të MAPL për këshillat komunalë për siguri në bashkësi, secila bashkësi që jeton në komunë duhet të ketë një përfaqësues në KKSB, pa marrë parasysh madhësinë apo ndjenjën e përkatësisë etnike të popullsisë. Kjo gjë, sidoqoftë, është e vështirë që të arrihet në praktikë për bashkësitë me popullsi shumë të vogël. Prandaj, është me rëndësi që të bëhet dallimi mes bashkësive shumë të vogla (49 pjesëtarë apo më pak) dhe bashkësive të mëdha (50 plus) kur të analizohet ajo se cilat bashkësi nuk janë të përfaqësuara në KKSB.
* Bashkësia shqiptare e Kosovës përmendet në kontekst të atyre të cilët janë në pozitë pakice në nivel komunal.


osbe
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**

# Puna dhe funksionimi gjatë vitit 2018

## Numri i takimeve që janë mbajtur gjatë vitit 2018

*Sipas Udhëzimit Administrativ 27/2012 dhe Udhëzimit Administrativ duhet të mbahen gjashtë takime në vit*




## Takimet e KKSB ku u diskutuan incidentet e sigurisë, trendet e përgjithshme apo shqetësimet që prekin komunitetet joshumicë




## KKSB që ka miratuar planin e punës bashkë me veprimtari që mëtojnë të trajtojnë shqetësimet e sigurisë dhe rendit të komuniteteve në pakicë numerike




## Takimet e KKSB ku u diskutuan incidentet e sigurisë apo trendët e përgjithshme a shqetësimet e sigurisë të komuniteteve




Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet institucionet që e kanë në mandat adresimin e shqetësimeve të sigurisë të bashkësive. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, OSBE-ja rregullisht monitoron punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletë informative mëtojnë që t'ju ofrojnë institucioneve gjegjëse indikatorë që mund të ndihmojnë për identifikimin e boshllëqeve dhe të përmirësojë respektimin.